# Bardhyl Selimi

# NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI LIBRIN *HERMAN BERNSTEIN – AMBASADORI AMERIKAN NË MBRETËRINË SHQIPTARE, 1930 –1933*




***Shkruar nga Mal Berisha***

Botuar në Tiranë nga  Edualba 2017

Gjatë ditëve të Panairit të Librit 2025 në Tiranë, m'u dha rasti ta takoja autorin e këtij libri dhe të shkëmbeja mendime me të, në praninë e dy miqve të mi kosovarë, Rexhep Rifatit dhe Afrim Konjufcës. Zoti Mal pati mirësinë të ma dhuronte këtë libër, botuar tetë vite më parë.
Ndonëse kisha lexuar më parë për ambasadorin Bernstein në Mbretërinë Shqiptare gjatë viteve 1930–1933, nuk kisha marrë ndonjëherë kaq shumë dijeni sa fitova nga monografia e zotit Berisha kushtuar atij. Nuk do të mësoja për jetën dhe veprimtarinë gazetareske e publicistike të këtij hebreu të madh, para dhe pas shërbimit diplomatik në Shqipëri. Aq më tepër, nuk do ta kuptoja dot ç'rol ka luajtur ky personalitet politik dhe social në ngjizjen dhe forcimin e miqësisë së vendit tonë të vogël me Amerikën e madhe demokratike.

Në veçanti, zbulova se Herman Bernstein ka përkthyer edhe në esperantisht! Në fakt, fillimi i shekullit XX shënoi një lulëzim dhe një përhapje të gjerë të Esperantos në Europë dhe në botë, përfshirë edhe Shqipërinë, e cila po shkëputej dhe po pavarësohej nga zgjedha shumë-shekullore otomane.
Ky intelektual model i dhjetëvjeçarëve të parë të shekullit XX "i këndoi Shqipërisë, lavdisë së saj antike,

Skënderbeut, konsolidimit të shtetit të pavarur shqiptar, tolerancës fetare, virtyteve tona, besës dhe mikpritjes shqiptare". (faqe 17)

Ambasadori amerikan gjeti një mikpritje dhe mbështetje të sinqertë nga Qeveria Mbretërore e Shqipërisë. Në një intervistë që ai i mundësoi gazetarit Aleksandër Poëell me Mbretin Zog, në fillim të vitit 1931, ky i fundit u shpreh për marrëdhëniet me shtetet fqinje: Greqinë, Jugosllavinë dhe Italinë. Mbreti përmendi:

• fyerjet greke ndaj shpalljes së pavarësisë së Kishës Autoqefale Shqiptare, Kishës Kombëtare Ortodokse të Shqipërisë;
• dështimin e Qeverisë së Greqisë për të hapur shkolla në zonat ku jeton minoriteti shqiptar në Greqi;
• çështjen e pasurive tokësore të shqiptarëve në Greqi, të cilat janë shpronësuar pa asnjë kompensim.

Mbreti shtoi se në Greqi nuk ka as edhe një shkollë të vetme për minoritetin shqiptar. Ministri grek i Punëve të Jashtme thotë se në Greqi nuk ka shqiptarë, por turq. Ne e dimë se jemi dy kombet më të vjetra në Ballkan dhe se na nevojiten marrëdhënie më të mira. Këtë e ka theksuar edhe lëvizja jonë kombëtare e shekujve XIX dhe XX. Lidhur me Beogradin, Mbreti e akuzoi Jugosllavinë për shtyrjen që na bënë drejt lidhjes së aleancës me Italinë,

duke nxitur në Dukagjin një revoltë në vitin 1926. Ai kritikoi sjelljen çnjerëzore të jugosllavëve ndaj shqiptarëve në trojet jashtë Shqipërisë.

Marrëdhëniet me Italinë, Mbreti i karakterizonte si marrëdhënie që mund të pësonin një krisje të thellë për shkak të sjelljes së Musolinit ndaj tij. Musolini nuk e ka marrë pushtetin nga populli, prandaj nuk e pyet kabinetin për vendimet që merr — vendime që nuk mbështeten në logjikë, por në impulse dhe ndjenjë. (f. 43–44)

Ambasadori bëri një vizitë më 5 qershor 1931 në Manastirin e Shën Gjon Vladimirit në Elbasan, ku u bind edhe më shumë për ekzistencën e harmonisë fetare midis shqiptarëve. Peshkopi shqiptar i tha atij:
“Ky shenjt — thotë ai — që ka bërë mrekulli, është sllav. Ka lindur në fshatin Vladimir, afër Krajës, në kufirin e sotëm midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Atëherë nuk kishte dallime midis serbëve, çekosllovakëve, bullgarëve dhe sllavëve të tjerë. Sllavët në atë kohë ishin thjesht sllavë; kudo që gjendeshin na donin dhe i donim edhe ne. Prirja e tij për bamirësinë, dëshira për të jetuar sipas udhëzimeve të Zotit dhe dashuria për vendin tonë na ka vëllazëruar me sllavët.
Edhe për faktin se në Jugosllavi ka një grua shqiptare

shenjtore. Ajo quhet Maika Angelika. Ajo ishte princeshë e një dinastie sunduese në Shkodër. U martua me një princ dalmat dhe, kur mbeti e ve, mori në dorë qeverisjen e një province midis Kroacisë dhe Sllovenisë. Sundimi i saj ishte aq i drejtë dhe bujar, sa shtetasit e saj njëzëri e konsakruan shenjtore të vendit të tyre pas vdekjes. Trupi i saj gjendet në Manastirin Ortodoks të Maika Angelikas në Vrushkaja Gora në Slloveni, dhe dita e saj e kremtimit është në stinën e verës. Mijëra e mijëra njerëz shkojnë atje çdo vit për t'iu lutur shenjtores shqiptare me një devocion po aq të madh sa edhe ne për Shën Gjon Vladimirin." (faqe 73)

Në libër flitet edhe për ndihmesën amerikane për hapjen e shkollave teknike. Një mik i Shqipërisë, Ericksoni, siguroi miratimin e qeverisë shqiptare për hapjen e shkollës bujqësore në Kavajë. Vlen të theksohet se, në formë anonime, vetë presidenti Hoover dha 10.000 dollarë. Ericksoni i pati shkruar atij se "shqiptarët janë njerëz të tillë që më mirë vdesin sesa të kërkojnë; më mirë mbarojnë në dëshpërimin e vet sesa të quhen lypsarë… Ata janë një popull tragjik, por një racë heroike." (faqe 82)
Shkolla u hap në vitin 1925.

Pasi At Gjergj Fishta i dërgoi ambasadorit një kopje të veprës së Gjeçovit për Kanunin e Lekë Dukagjinit, ky e falënderoi dhe i shkroi ndër të tjera:
“Një përmbledhje e pjesëve të caktuara të Kanunit të jashtëzakonshëm të Lekë Dukagjinit më ka ndriçuar pamjen e ligjeve me të cilat malësorët e veriut të Shqipërisë janë qeverisur në të kaluarën. Prifti françeskan At Shtjefën Kostandin Gjeçovi, i cili e ka hedhur në të pastër tekstin e këtij Kanuni të kodifikuar gjatë jetës së Skënderbeut dhe përgatitur prej Lekë Dukagjinit III, ka bërë një punë të pallogaritshme. Paraqitja e tij prej jush, së bashku me parathënien që i keni vënë, e kthen atë në një vlerë të paçmueshme historike.” (f. 91)

Në një shkrim të tij, “Shqipëria — Belgjika e Europës” (f. 99), Bernstein shkruan:
“Shqipëria nuk është vetëm vendi më pak i njohur, por edhe vendi i prezantuar më keq në Europën e sotme. Ajo është viktimë e propagandës së fabrikuar dhe të shpërndarë në disa prej vendeve fqinje, për qëllime politike dhe egoiste të tyre.”

Interesante janë vërejtjet e ambasadorit në shkrimin “Përse shqiptarët e kanë humbur besimin tek italianët” (f. 102–103):

• Automobilët ndalojnë në rrugë sepse motorët nuk funksionojnë me atë gazolinë (italiane — shënimi im, B. S.), për shkak të benzinës së përzier me ujë nga italianët.
• Firmat italiane të ndërtimit ofrojnë kosto më të ulëta se ato shqiptare, por nuk i kryejnë si duhet punët publike. Kështu ka ndodhur me Spitalin Ushtarak, për shembull. Po ashtu me rrugën Durrës–Elbasan.
• Punëtorët shqiptarë në këto firma nuk e marrin mëditjen sipas kontratës.
• Sipas ligjit shqiptar, nuk pranohen punëtorë të pakualifikuar nga Italia. Por autoritetet italiane falsifikojnë të dhënat e kualifikimit për këta punëtorë, në mënyrë që të vijnë në Shqipëri… etj., etj.

Shumë është përfolur “tradhtia” e Zogut, që “ia paska falur” Shën Naumin dhe Vermoshin Jugosllavisë. Në faqen 134, edhe ambasadori Bernstein shpjegon se ky ka qenë një mashtrim i madh.

Në fakt, për të hequr dorë nga Manastiri i Shën Naumit, qeverisë shqiptare i ishin dhënë fshati Peshkëpi, Lugina e Çërravës, Kisha e Ujit të Shenjtë dhe kodra strategjike e Shën Naumit, së bashku me pikat kufitare të patrullimit jugosllav. Kështu, territori i fituar përbënte një zonë prej rreth 22 kilometrash katrorë.
Përveç kësaj, ishin siguruar lugina e kullotave të

Libovicës, dy shtëpi të fshatit të Grençes, rruga e Lumbrasë bashkë me kullën vrojtuese turke, kodra dhe liqeni, pjesa e pasme e Velipojës, tërë malet sipër saj, dhe kufijtë ishin zgjeruar me rreth njëzet e pesë kilometra.
Ky shkëmbim territoresh nuk u bë për të plotësuar një dëshirë të qeverisë jugosllave, e cila ende besonte se regjimi i Zogut, ashtu si ai i Esat Pashës, ishte i pafuqishëm dhe puthador ndaj jugosllavëve.

“Ne — thoshte Mbreti — vuajmë për njerëz të aftë e të përgjegjshëm. Unë kam në kabinetin tim dy vetë të cilët kanë qenë kundërshtarët e mi, armiqtë e mi. I kam marrë sepse besoj se ata mund t’i bëjnë shërbime të mira shtetit.”

Lidhur me një propozim francez për një federatë europiane në shërbim të paqes, Mbreti shfaqet mosbesues. Ai thotë se në Europë ka kufij si natyrorë, ashtu edhe shtetërorë. Ka kaq shumë kufij artificialë, disa prej të cilëve janë sanksionuar qysh prej Luftës së Madhe, si për shembull ato të Polonisë, Jugosllavisë, Greqisë dhe Shqipërisë.
“Është e pamundur të shuash dhimbjen e kombeve vetëm duke u ofruar atyre të gjenden së bashku nëpër

konferenca, veçanërisht kur shohim se brengat më të mëdha as që konsiderohen fare.” (f. 143)

Në një kablogram drejtuar Departamentit të Shtetit, ambasadori Herman Bernstein flet për marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave (f. 135):
“Traktati i Miqësisë dhe Bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Italisë ka shkaktuar një irritim të madh në Beograd. Mbreti pretendon se më parë ai ishte kritikuar shumë, sepse ishte treguar tepër miqësor me Jugosllavinë. Më pas, me rebelimin e dhjetorit të vitit 1926 në veriun e Shqipërisë, të nxitur dhe të shkaktuar prej jugosllavëve (sipas Mbretit), dhe pas shtypjes së revoltës, atij i dukej si veprim i mençur të nënshkruante një traktat të tillë me Italinë.
Problemi me minoritetin shqiptar në Jugosllavi përbën një arsye tjetër të përçarjes. Mbreti i përmbahet idesë se popullsia shqiptare e Kosovës po shpërngulet drejt Kroacisë dhe gjetkë, ndërsa malazezët dhe sllavët po vendosen në fshatra krejtësisht shqiptare, përgjatë vijës ndarëse të Kosovës, si dhe në zona të tjera, me qëllim që të shpërbëhet karakteri shqiptar i këtyre vendbanimeve. Mbreti thotë se nuk ka qoftë edhe një shkollë të vetme ku të mësohet gjuha shqipe.”

Interesante janë rrëfimet për Mesianin fals Sabatai Zevi, për të cilin kam dëgjuar se ka ende një varr diku në jug. Flitet për një hebre të shekujve XV dhe XVI. Duke cituar një dokument gjerman të vitit 1611, Bernstein përmend se, me përkeqësimin e Inkuizicionit gjatë pontifikatit të Papa Pavlit IV, shumë bashkësi hebreje u larguan nga Ankona dhe erdhën në Shqipëri.
Sabatai u bënte thirrje hebrenjve të shkonin në Tokën e Premtuar. Për këtë arsye, sulltani e kërcënoi me vdekje nëse ai nuk kthehej në islam. Sabatai pranoi dhe u internua në Ulqin. Vitet e fundit të jetës i kaloi në Berat, ku formoi një sekt islamik që ekziston ende sot. Kur vdiq dhe po e dërgonin në varr, i gjetën nën jastëk librin e shenjtë hebre të Torahut, jo Kuranin — pra, ai kishte vazhduar të predikonte fshehurazi judaizmin. (faqe 152)

Më tërhoqi edhe një krahasim që bën Bernstein midis Shqipërisë së asaj kohe dhe Meksikës antisemite. (faqe 162)
Në ngjashmëri me “bluzat e kafejta” naziste, në atë kohë në Meksikë ishin formuar “bluzat e arta”. Organizata fashiste meksikane padyshim nuk përfaqëson shpirtin e sotëm meksikan. Ajo kërkonte që hebrenjtë të mos lejoheshin në Meksikë, të mos u jepej poste politike dhe t’u konfiskoheshin fabrikat.

Nga ana tjetër, në atë kohë Mbreti i Shqipërisë lëshoi një ftesë zyrtare për bizneset hebraike që të vendoseshin në Shqipëri dhe të ndihmoheshin me çdo mënyrë sipërmarrjet tregtare të ndërmarra prej të ardhurve të rinj.

Simpatia e Bernsteinit për shqiptarët dhe Shqipërinë nuk shihej me sy të mirë nga qarqet diplomatike italiane, të cilat thonin se “Bernsteini ishte shqiptarizuar”. (f. 192) Sikurse e përmenda në fillim, para ardhjes në Shqipëri, ambasadori Bernstein ishte marrë me gazetari. Bie në sy një artikull i tij për planet e Kajzerit gjerman Vilhelmi II dhe Carit Nikolla II të Rusisë për ndarjen e botës midis tyre. Këtë, gazetari e zbuloi në dokumentet që dolën pas revolucionit socialist të tetorit1917 në Rusi, që përmbysi Carin. (f. 237)

Në librin e tij “Me mendje-ndriturit” përfshihen intervistat e bëra me personalitete të shquara të botës së artit, shkencës dhe politikës së asaj kohe, si: Leon Tolstoi, George Bernard Shaw, Auguste Rodin, Henri Bergson, Papa Benedikti XV, Pjotr Kropotkin, Leon Trotski, Chaim Weizmann, Sheik-ul-Islam, Havelock Ellis, Romain Rolland, Albert Einstein, Theodore Roosevelt, Woodrow Wilson etj. (f. 247).
Ai thotë:

“Unë i kam përvetësuar teoritë shkencore më moderne sepse m’i ka shpjeguar Metçnikov; kam diskutuar për fenë dhe artin me Leon Tolstoin; parimet e filozofisë moderne m’i ka dhënë Henri Bergson; diplomacinë botërore dhe çështjet ruse m’i kanë analizuar Konti Witte dhe Maksim Kovalevski; teorinë e artit ma mësoi Auguste Rodin; shtetformimin ma shpjeguan Theodore Roosevelt dhe Woodrow Wilson; mbrojtjen e të drejtave të grave Havelock Ellis; imperializmin gjerman Hans Delbrück; letërsinë dhe pacifizmin Georg Brandes; politikën e luftës dhe paqes së Vatikanit Papa Benedikti XV; islamin ma shpjegoi Sheik-ul-Islam, i cili e shfronësoi Abdyl Hamitin; ndërsa sionizmin ma mësuan Nordau, Weizmann dhe Albert Einstein.”

Revolucionin rus ma shpjegoi Trotski, liberalizmin britanik e mësova nga Lordi Robert Cecil, dramën kontinentale e pashë tek Arthur Schnitzler, historinë e Japonisë ma tregoi Marquis Ōkuma dhe gjithçka tjetër ma nguliti në tru George Bernard Shaw.
Në faqen 258, me pak rreshta, ai përshkruan magjishëm përshtypjet nga Leon Tolstoi:
“Me të jam ndjerë si një rreze e shndritshme në mbrëmjen vezulluese të perëndimit të diellit, kur kap Tokën, ndërkohë që dita po i lëshonte vendin natës. Një

vizitë aty ishte si të shkoje në një vend të mrekullive, aty ku të mahnit arti magjik. Në intelektin dhe vizionin e tij e pashë veten miliona milje larg Tokës, duke vështruar magjishëm laboratorin e shkëputur nga vaniteti i species njerëzore."

"As luftë, as paqe" ishte thelbi i një letre që arriti ta siguronte Bernstein, dërguar nga Brest-Litovski për Leninin dhe Stalinin, ku sugjerohej formula: "Ne shpallëm mbarimin e luftës dhe çmobilizimin, pa nënshkruar traktat paqeje."
Ai parashikonte revolucion në Gjermani, prandaj i shkruante Iliçit se do t'i jepte fund luftës pa nënshkruar traktatin. Fjalët e Trotskit "as luftë, as paqe" simbolizonin qëndrimin e Rusisë në atë kohë. (faqe 263)

Në vitin 1922, Bernsteini viziton Sarajevën, aty ku kishte ndodhur atentati ndaj princit trashëgimtar austriak, i cili u mor si pretekst për shpërthimin e Luftës së Parë Botërore. Ai vuri re dy prirje: atë për një shtet militarist (të mbështetur nga serbët) dhe atë për republikë (të mbështetur nga joserbët).
"Serbët po përpiqeshin të themelonin një Serbi të fuqishme militare nën murin e Jugosllavisë, ndërkohë që kroatët dhe sllovenët ishin për një ekzistencë paqësore, si republikë." (f. 270)

Monografia prej 330 faqesh e zotit Mal Berisha shtjellohet me një gjuhë të pastër shqipe, rrjedhshëm dhe këndshëm. Cilësia e letrës dhe e kopertinës është shumë e mirë. Ajo shoqërohet me shumë referenca dhe me një tregues emrash në fund.
Bardhyl Selimi, 20 nëntor 2025